

Procesverbal

Nga seanca e II-të(dytë)/2019 e Kuvendit Komunal të Dragashit, e mbajtur më 06.03.2019, duke filluar në ora 10.00, me këtë:

R e n d i t e

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Procesverbalit nga seanca e I-rë/2019 e KK-së Dragash..,
2. Shqyrtimi dhe miratimi i Raportit të Punës së kryetarit & organeve ekzekutive të Komunës së Dragashit, për vitin 2018 dhe planeve të punës, për vitin 2019...,
3. Njoftimi me raportin e punës së Këshillit Komunal për Siguri në Bashkësi, për vitin 2018 & Plani i Veprimit, për vitin 2019..., dhe
4. Eventuale...

Seancën, me përshëndetjen e të pranishmëve... e hapi kryesuesi i KK-së z.Betim Merdiu, me kërkesën dhe deklarinimin e delegatëve, nëse ka vërejtje apo plotësime të rendit të ditës, të dërguar me Ftesë...? Nëse nuk ka, miratojmë, njëzëri, rendit e ditës-sipas Ftesës...

Pika e I-rë (parë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me punën dhe, si zakonisht, fillimisht, kemi shqyrtimin dhe miratimin e Procesverbalit nga senca e I-rë/2019, nëse ka vërejtje apo plotësime...? Nëse nuk ka, e miratojmë edhe Procesvebrbalin e seancës së kaluar - I/2019.

Pika e II-të (dytë) e rendit të ditës

Vazhdojmë me pikën e II-të të radhës ku kemi shqyrtimin dhe miratimin e Raportit të Punës së kryetarit & organeve ekzekutive të Komunës, për vitin 2018 me planet e punës, për vitin 2019 dhe, fillimisht, fjalën e ka kryetari i Komunës z.Shaban Shabani...

Kryetari- "Gjatë vitit kalendarik-2018 puna e organeve komuna është zhvilluar përmes 8 drejtorateve dhe shërbimeve të tyre në harmoni me LV Lokale dhe UA-e e Statutin e Komunës, duku u punuar në interes të Komunës, përmes zbatimit të ligjeve dhe dispozitave lidhur me obligimet e kompetencat e Komunës. Organt komunale kanë punuar duke respektuar afatet kohore me rastin e shqyrtimit dhe vendosjes sipas kërkesave të qytetarëve, institucioneve dhe shoqërisë civile. Të gjitha kërkesat dhe shkresat, që janë shqyrtuar nga ana e organeve komunale, janë përfshirë, numerikisht dhe në mënyrë analitike janë prezantuar, në raportet e drejtorateve, veqe veq. Edhe krahas detyrave të kryera në vitin 2018, për vitin 2019 ngel obligim permanent se organet tona duhet të janë sa më të sakta dhe azhuer në ofrimin e shërbimeve efikase qytetarëve dhe me respektimin e e procedurave ligjore për hartim të rregulloreve e vendimeve të ndryshme, sipas nevojave që paraqiten në praktikën e përditshme e për të mirën e qytetarëve. Në takimet e përditshme dhe Bordin e Drejtorëve i kemi anlizuar aktivitetet, duke dhënë porpozime për ndryshime dhe plotësime të sjelleve dhe parregullësive, që sugjerimet dhe vërjejtjet e qytetarëve dhe organeve kompetente të merren parasysh e që i janë adresuar Zyrës së Kryetarit dhe zyreve tjera të cilat kanë qenë të hapura për komunkime të ndryshme për bashkëpunim me institucionet

e ndryshme. Në të gjitha kontaktet me institucionet ndërkombëtare, më së shpeshti, kanë ardhur në shprehje iniciativat, kërkesat dhe nevojat e qytetarëve tonë nga lokalitetet e ndryshme për shumë projekte zhvillimore, siç ka qenë rasti i realizimit të shumë iniciativave përmes UNDP-së, ADA-së, SIDA-së etj. Po ashtu, ka pasur aktivitete lidhur me përmirësimin e çështjeve të sigurisë me iniciativa të ndryshme që i kontribuojnë përmirësimin të gjendjes. Sa i përket gjendjes së sigurisë, mund të themi se gjendja është stabile, pa kurrfar konflikte e probleme ndëretnike e për këtë gjendje kontribut kanë dhënë organet kompetente të sigurisë, KKSB-ja dhe akterët tjerë që merren me çështjet e sigurisë. Po ashtu, dua të theksoj se edhe në sferën e klaturës, janë mbajtu manifestimet shtetërore e komunale, siç janë. Dita e Pavarësisë, Dita e Flamurit, të cilat kanë kaluar në mënyrë më të mirë të mundëshme dhe se këto manifestime janë bërë traditë në komunën tonë dhe si të tilla janë përkrahur, materialisht, nga Komuna. Sfidë për organet komunale ngel zvogëlimi i rasteve sociale, pasi se për kënaqjen e rasteve të tilla mjetet janë të limituara e në këtë kontest është edhe Ligji për Faljen e Borgjeve, si dhe kemi miratuar Vendimin linear për mbulimin e shpenzimeve të varrimit pre 100,00 eurove. Edhe pse ka pasur iniciativa pozitive, po theksoj se nuk do të ndalemi me kaq, pasi se edhe më tej do të punojmë në mbrojtjen e florës e faunës për të arritur qëllimet e zhvillimit, biodiversitetit të Komunës, zvogëlimin të pa punësisë etj. Presim që diskutimet tuaja lidhur me këto dokumente t'i kontribuojnë përmirësimin të gjendjes në periudhën e mëtejme”.

z.Samidin Xheladini- E falënderoj pushtetin ekzekutiv në raportet e ofruara, edhe pse një numër i drejtorëve kanë ofruar material të gjerë e disa të shkurtër. Sa i përket tekstit hyrës dhe fjalës së kryetarit, kryesisht kemi të bëjmë me lavadata dhe të arritura gjatë vitit 2018 e për këtë Raporti është i mirë dhe teknikisht në rregull, pasi se flitet për të arriturat e anashkalohen problemet dhe zgjidhja e tyre. Kështu, nuk janë cekur problemet lidhur me furnizimet me ujë, projektet e pa përfunduar reth kanalizimeve, mos vendosja e kolektorëve, gjendja e pa kënaqëshme reth rrugët rajonale e lokale, menaxhimi me mbeturina, çështja e punësimeve, pastrimi i rrugëve nga bora, mos përkrahja e duhur e fermerëve në bujqësi e blegëtori, dëmtimi i natyrës dhe biodiversitetit të një pjese të territorit tonë, mos përkrahja e turizmit në zonat turistike, apo, më mirë të thuhet, diskriminimi i një pjese të territorit dhe investimet e gabuara. Në Raportin e kryetarit nuk ka kurrfar ankese në 8 drejtorate komunale dhe është çështje se sa takime janë mbajtur për këtë, që qytetarët vetë të paraqesin ankesat? Po theksoj se qytetarët kanë ankese e që janë të bazuara e, kryesisht, kanë të bëjnë me çështjet e punësimeve, procedurat tenderuese, dëmtimeve të pronave shoqërore e private dhe mos zgjidhja e probleme me të cilët ballafaqohen qytetarët. Përmendet përfundimi i sukseshëm i tenderëve në vlerë prej 2,2 milionë euro me çmime më të ulëta e që në, të shumtën e rasteve, punët nuk kanë përfunduar si duhet e sipas tendereve e projekteve. Gjithashtu qëndron këtu se nuk janë realizuar 500 mijë eurot për ujësjellësin qendror, për shkaqe objektive e, jo për fajin e organeve komunale?! Këtu kush është fajtor kur OQPP-ja ju ka sqaruar rrugët se si të zgjidhet rasti e që ju nuk i keni marr parasysh për shkak të inateve dhe tekeve të dikujt?! Për këtë, apeloj që çështja të zgjidhet në mënyrën më të mirë të mundëshme, duke mos i cenuar ligjet dhe rregullat në fuqi, pasi se shumë fshatra kanë ngelur pa ujë. Për vitin 2019 parashihen 2,8 milionë euro për 87 projekte të investimeve kapitale, që apeloj për t'u filluar menjëherë me realizimin e tyre e mos të pritet vjeshta për fillim të punimeve, pasi se për ata 3 mujët e fundit të vitit nuk mund të logarisim, për shkak të kushteve atmosferike dhe konfiguracionit të terrenit te ne. Parashihet edhe dhënia e përkrahjeve nga ana e AKP-

së e që mendoj se pronën shoqërore duhet këthyer Komunës për menaxhim në emër të qytetarëve të sajë. Theksoni se obligim permanent e keni zvogëlimin e papunësisë dhe përkrahja përmes subvencioneve në shumë prej 44 mijë euro dhe, për shkak të transparencës, do të kisha kërkuar që të na dërgoni Listën se kush me sa është përkrahur me subvencione, pasi se ka ankesa. Takimet publike- debatet publike-7 e nuk dihet se ku janë mbajtur këto takime dhe se çka është debatuar në to? Edhe te Plani i Punës së Kuvendit, te pika 7 theksohet 3-mujori i parë e duhet të qëndron në 3-mujorin e dytë. Te DAdiministratës mjaft lavdata dhe s' di se sa janë në dijeni me gjendjen e higjienës në ZLokale në Bresanë e ku nuk ka ujë?! DEFinanca ka marr pjesë në disa debate publike në disa fshatra e pse kjo bëhet në mënyrë selektive e nga ZTPronë kemi inkasimin më të vogël për 30 mijë euro se në vitin 2017 dhe më intereson se sa është shuma e borgjeve dhe se e kani plan konkret të borgjeve të mbetura? Plani i buxhetit duhet të shkon nëpër secilin lokalitet e jo selektivisht, me delegatë? Te DArimit theksohet se paska arritur transparencë të madhe dhe se paskan hartuar Planin e Veprimit për vitet 2019-2023, për çka i përgëzoj dhe se theksojnë se kanë pasur vizitë speciale në shkollën e Krushevës për të shqyrtuar ankesat e drejtorit e që dëshirojmë të dihet se për çfar ankese është fjala? Po ashtu, përmendem konkurset dhe hapja e vendeve të reja të punës për mësimdhënës të kualifikuar e këtu, lirisht mund të themi se, u punësuar ata që janë të afërtë me pushtetin dhe se drejtori i arsimit po manipulohet nga personi-at e caktuar "x", si dhe përmendet vëllazërimi me një shkollë të Kukësis. Në testet e maturës kemi rezultatet për 184 vijues dhe vetëm 56% janë zgjidhur pozitivisht e kjo është shqetësuese, pasi se më se gjysëma e nxënësëve nuk e kanë kaluar testin?! DKA-ja siguron transportin e nxënësëve në realcionin Pllav-Llopushnik, Dragash-Rrenc e është dashur të përfshihet edhe Kosava, për çka është vendosur në këtë Kuvend? Në Raport përmenden mjaft aktivitete e që, në realitet, janë detyra të përditshme të drejtorateve e, në fakt, nuk ka aktivitete të posaçme që janë ndërmarr?! Te DSHMS ai vetëm se është shkurtuar, nuk ka shënime reth shërbimeve e duhet të përfshihen ato në shërbime dhe laroratore? Është përmendur se zyrtarët e laboratorëve kanë ofruar shërbime për 11 mijë pacientë dhe 2800 shërbime për rentgene e në fund të vitit 2018 janë blerë 2 aparata të analizave bio-kimike e që analiza blëhen në QMF të Krushevës e që Bresana ngel për vitin 2019, edhe pse ka më shumë pacientë e që, në fakt, është ofruar aparaturë e vjetër në vend të resë e për këtë mund të dëshmoj se është sjell aparatura e përdorur?! Mjerisht, për shkak të pakujdesive po ngjajnë gjëra të këtilla e për këtë, përmes donacionit të Zyrës Japoneze, kanë qenë 69 mijë euro mjete për QKMF-në e me ato mjete janë blerë aparatet, për çka i falënderoj, por çka na ndodhi-u ofru aparati i vjetër me numër tjetër serik i cili qëndron në letrën garantuese, që do të thotë u bënë manipulime e fjala është për aparat për naliza urinale i cili kushton 12 mijë euro, në emër të aparait të ri e që, për shkak të pa përgjegjësisë të dikujt, 2 vite ka qëndruar në depo?! Për këtë aparatuarë, konsideroj se, fillimisht, duhet të bëhet testimi se a bëhen analiza të sakta e mos të merret dikush si viktimë me ofrimin e rezultateve të gabuara e që, në bazë të tyre, mjekët të pëshkruajnë diagnoza të gabuara?!

z.Sefidin Meizini- E kemi Rportin, por me sa e dij ne i kemi 9 drejtorate e unë i kam veqar 3 prej tyre me të cilët jam më i pa kënaqur. Për Shëndetësinë, kolegu theksoi disa gjëra dhe është mjaft shqetësuese rasti me sigurimin e atyre aparatëve të analizave dhe s' di se si është lejuar kjo e përgjegjës në këtë Drejtorat është z.Behar Brenolli dhe se jeta e qytetarëve atje nuk është aspak më e pa vlerë se sa e atyre në Dragash apo Krushevë dhe s' di se si është lejuar kjo?! Sa i përket mungesës së gjinekologut, kjo është brengosëse dhe se banorëve duhet ofruar shërbime të këtilla e jo të shkojnë në Prizren. Te

DUrbanizimit ka vërejtje dhe fakti se aty është pensionuar një punëtor e tani mungon personi me përgatitje adekuate të gjeodezisë e ne kemi njerëz që kanë mbaruar shkollime të tilla e po na punojnë si kamarier e për këtë kërkoj sqarime? Lidhur me DSHPublike, më së paku, pajtohem, pasi se theksohet se gjatë sezonit të pastrimit të rrugëve nga bora qenka anagzhuar edhe Njësia e tyre e që është pozitive. Por, nuk e dijmë se drejtori a e ka përcjell gjendjen gjatë dimërit, apo ka qëndruar në shtëpi e nuk ka ardhur në punë e konstaton se gjendja ka qenë e mirë?! Me këtë konstatim jemi të ofenduar ne qytetarët, pasi se 15 fshatra janë lënë në mëshirën e një traktori e që gjendja në këtë shërbim të vlerësohet me notat 4 e 5, unë ata punëtor do t'i kisha përjashtuar nga puna?! Për këtë, duhet të jemi pjesërisht të kënaqur me notën 2+. Po ashtu, duhet nxjerr ndonjë Rezolutë, me të cilën ne do të mbrohemi e jo të sulmohemi në rrugë, nga çdo kush sipas qejfit?!

z.Laurat Krasniqi- Kam dy çështje apo shqetësime të DUrbanizimit ku qenkan dhënë 14 liçenca apo leje për ndërtim të objekteve, për ndërtesën në Dragash se a është dhënë Leje Ndërtimi e ajo po përfundon?! Kjo paraqet përgjegjësi të madhe për kryetarin dhe ekzekutivin e Komunës e nuk kemi pasur mundësi që të diksutojmë lidhur me Planin Rregulativ të Dragashit?! E dyta, performancat e Komunës, nga GAP-i apo MAPL-ja e që Komuna e Dragashit nuk ka mundur të merr grant, nga se ka pasur mjaft rekomandime negative nga ana e Auditorit Gjeneral e organet komunale nuk i kanë marr në konsideratë, por kanë punuar, me të vjetrën?!

z.Kryesusi- I kisha lutur delegatët që të flasin më ngadal për shkak të përkthimit e Procesverbalit. Ndërkaq, po theksoj se të gjithë ne këtu jemi të zgjedhurit e popullit-pavarësisht nga pozicioni apo subjekti politikë dhe se, as kryetari, nuk mund të mbron drejtorët për punë të gabuar dhe atë që theksoi z.Samidin Xh. është e vërtetë e kjo nuk duhet të kishte ndodhë, apo të përsëritet, dhe ai aparat që është sjell, si i tillë, do të kthehet prapa?!

z.Naser Myrtezani-Ne nuk kemi vërejtje reth Raportit, ngase Komunës, i nevoiten raporte, por që kërkojmë rezultate konkrete në terren. Kjo shifet si dallim në mes të asaj që ceket se janë realizuar 66 tenderë në vlerë prej 2,2 milionë euro, si dhe kemi shifrën e projekteve për vitin 2019 prej 2,8 milionë eurove e që do të thotë se kjo ekziston në letra e në praktikë gjendja është ndryshe, nëse delni në terren e të shifni se çka është bërë me ujësjellësit, në arsim, shëndetësi etj. Lidhur me arsimin kemi mjaft vërejtje, edhe pse kemi iniciativën e MASHT-it për mbajtjen e testeve të ndryshme dhe garave nëpër shkollat e si t'i zhvillojmë ato kur nëpër shkollat tona mungojnë kabinetet adekuate, si nëpër shkollat e komunave tjera. Pra, gjendja nëpër shkollat është tejte e keqe dhe kërkoj nga drejtori që të del në terren dhe të bindet për gjendjen në shkollat e jo që, formalisht, të viziton shkollat dhe të ndanë çertifikatën?! Do të ishte më mirë të shifni mundësitë se si t'i stimuloni nxënësit e caktuar apo shkollat me mjete, duke krijuar edhe fonde. Në anën tjetër DKulturës ka organizura manifestime të caktuara, që nënkuptohet. Por, mënyra se si janë organizuar është mjeruese dhe marri, pasi se nxënësit kanë mërddhi atë Ditë të Pavarësisë më 17.02.2019, nxënësit kanë luajtur futboll e nuk keni parë të arsyeshme që t'u jepni, s'paku, nga një hamburger, edhe pse dihet se sa është buxheti për këtë?! Në këtë mënyrë, janë maltretuar mësimdhënësit dhe nuk është ditur se kush është organizatori dhe se nxënësit, atë ditë, na kanë ardhur plotësisht të djerësitur nga garat e futbollit. Te Bujqësia, kemi fermerë të interesuar për subvencione e projekte të MBujqësisë e te ne nuk po përfshihen raste të tilla, siç kemi këtu problem në f.Pllajnik ku

qytetarët e tij nuk po mund të konkurojnë, pasi se nuk janë të përfshirë në zonë kadastrale, e që është si fshat i interesuar për të punuar në bujqësi e blegëtori. Po a shtu, edhe nëpër fshatrat tjera, ku fermerët kanë nga 2-3 lopë, ata nuk po stimulohen dhe ndihëmhohen, por ata me më shumë frymë lopë?! Për ujsjellësin e kanalizimin as mos të flasim, pasi se në fshatin Bresanë ku u investuan 120 mijë uro, gjedja është më e keqe se siç ka qenë e lere më të flasim për kanalizimin në fshatin Zaplluxhe, pasi se është ndërtuar dhe është shkatërruar?! Lidhur me shëndetësinë, siç theksuan edhe kolegët parafolës,, për paisjet e parapara u “luajt loja”, edhe pse dihet se është fshati më i madh e nevoiten shërbime 24 orë, përfshi edhe funksionimin të shtunave dhe të dielave, që kështu të arsyetoni votat e fituara?! Për këtë e keni shansën, pasi se 3-4 personat kyç udhëheqës të Komunës janë nga Bresana dhe se nuk ka nevojë që, në mëngjers, të vendosni kollaret e të vini në punë e të lëvdëroheni se njeri nga ju është kryetar e tjetri nënkryetar apo kryesues i Kuvendit dhe, vërtetë, është marri që kjo po ngjan me Bresanën?!

z.Rexhep Kamberi- Do të jam i shkurtër dhe po theksoj se përkrahi Raportin me planet dhe pajtohem me konstatimet se gjendja politike dhe ndëretnike në Komunën e Dragashit është më e mirë në 15 vitet e fundit. Nuk kam vërejtje thelbësore në punën e kryetarit, por kam sugjerim për kryetarin dhe ne delegatët, që të kemi më shumë kujdes me rastin e shpalljes dhe besimit të tenderëve, pasi se ata që po i fitojnë tenderët, sipas çmimit më të ulët, pastaj në çdo mënyrë po tentojnë të kursejnë, duke e kompenzuar këtë me mos punë serioze. Kjo më së miri shifet me rastin e Kompanisë “Drini” të cilët e kanë marr me tender pastrimin e rrugëve dhe kanë pasur aq kompetenca sa që kryetari dhe organet jera komunale nuk kanë pasur mundësinë që të kërkojnë e urdhërojnë pastrimin e rrugëve?! Për këtë, propozoj që, me rastin e shpalljes së tenderëve, sidmos për pastrimin e rrugëve nga bora - vitin tjetër, që Komuna të nënshkruan Kontratën por të ketë pjesëmarrje aktive DSHPublike i cili e njëj këtë problematikë. Po ashtu, pajtohem që punët reth realizimit të projekteve të fillojnë menjëherë-tani në Pranverë, si dhe kam një kërkesë për kryesuesin e që, në seancën e radhës, të jetë në rend dite çështja e shpronësimit të një rruge në pjesën poshtme të Dragashit, për një pjesë të banorëve që nuk kanë rrugë për të lëvizur lirshëm, me fajin e 1 apo 2 familjeve, kurse ajo rrugë është e rëndësishme për t’u krijuar një lidhje e mirë për qytetarët dhe lehtësuar trafiku për Dragashin.

z.Sefidin Mejjini- Pasi se kolegu parafolës theksoi se nuk paskemi të drejtën të kritikojmë drejtorët dhe pushtetin ekzekutiv për rrugët, që është logjikë e sëmur, e ne ja kemi dhënë në menaxhim Kompanisë “Drini” rrugët, po u dashka që tani të flegjmë e që po na del se vetëm ajo Kompani qenka përgjegjëse e kjo është absurde dhe, nëse dëshiron të mbron diskush drejtorin, këtë duhet t’a bëjsh me mënyrë më të argumentuar?!

z.Zinaida Elmazi- Unë do të jam e shkurtër dhe do të kërkoj që, secili nga ne, të ketë kohën e kufizuar kur të del në foltore e mos të “sillemi në rreth” e që diskutimet të janë 5 minuta për secilin? Do të parashtroj një pyetje lidhur me DBujqësisë e që këtu qëndron zbatimi i Ligjit të Bujqësisë dhe, nëse është kështu, ciliin Ligj e zbaton Inspekcioni e nuk i shëf deponitë në çdo hap e që i krijojnë ndërmarrjet tregtare-ndërtimore. Ndërkaq, dje, në mbledhjen e KPFinanca, kam kërkuar që në rend dite të jetë edhe sjellaj jonë si delegatë, ku jemi përfaqësues të popullit. Kur e them këtë, e kam për bazë mbështetëm në atë se, kur janë në pyetje manifestimet-ceremonitë festive me karejkte shtetëror, për çka nuk paguhemi me pjesëmarrjen tonë, për këtë, ndoshta, nuk po marrim pjesë?! Psh.ne ceremoninin e Ditës së

Pavarësisë së Kosova, nga gratë, ishim vetëm 2 - nga ne nga komuniteti jo shumnicë e kjo nuk është në rregull, nga se në këtë mënyrë nuk po e japim kontributin tonë, sepse po shfrytëzojmë benificionet e nuk po respektojmë obligimet e përgjegjësitë tona?! Kur është dashur që, pa pagesë, të shëtitet nëpër Kosovë, vizitohet Shqipëria etj. atëherë jemi delegatë të këtij Kuvendi e kur duhet të japet kontributi, jemi nëna, motra dhe kemi obligime familjare, sikurse që i ngrisim, unanimisht, duart kur duhet të sigurojmë "lap-topa". Edhe kur janë në pyetje udhëtimet nëpër shetet tjera, po gjejmë kohë të lirë për t'u paraqitur dhe marr mëditje, të cilat, na takojnë ose nuk na takojnë?!

z.Refik Latifi- Raporti i Punës na jep aktivitetin e tërësishëm të organeve ekzekutive komunale e unë nuk do të ndalem shumë te raportet e drejtorateve, meqenëse kolegët dhanë disa nga vërejtjet e do të potencoj disa çështje që kanë të bëjnë me disa njësi në Zyrën e Kryetarit e që nuk i kanë dërguar raportet apo planet e punës. Pra, unë flas këtu për Zyrën Ligjore, Shërbimin Kadrovik-Personelit, Auditorin e Brendshëm e që duhet t'i kishim e sidomos për Auditorin e Brendshëm, meqenëse nuk e kemi pasur fare e duhet pasur parasysh rolin që ka në shoqërin demokratike e cila parashef që pushteti lokal duhet të jetë sa më e hapët në aspektin e shfrytëzimit të fondeve publike. Pra, administrata publike duhet të jetë sa më shumë transparente në shfrytëzimin e fondeve publike, siç duhet të janë publike rregulloret, hapja ndaj mediave etj., e që monitorimi për këtë është më se i nevojshëm e i domosdoshëm.

z.Velid Haxhisin- Unë, fillimisht, do të shprehi kënaqësinë që sot kemi prezent shumicën e drejtorëve e që më herët nuk ka qenë rast?! Do të filloj nga vetë ne-Kuvendi ku me Plan kemi paraparë se çka do të punohet, përfshi edhe komisionet. E kemi pasur Komisionin për Bashkëpunim me Fshatrat i cili nuk ka mbajtur takime e nuk është zgjedh kryesuesi i Komisionit. Po ashtu kemi Komisionin për Pronën Komunale dhe atë për Ankesa në Pronën Komunale e që duhet të dijmë për punën e tyre. Kur flasim për DAdministratës, ZProkurimit nuk na ka ofruar Raport se sa ka qenë efikase? Ne e kemi pasur rastin e njohur reth ujësjellësit qendror e në Raport nuk kemi asgjë, pos deklarimit të kryetarit e, realisht, nuk e dijmë se si qëndron çështja? Kemi projektin e mos kryerjes së projektit të urës në Krushevë e që nuk e shoh se dikush nga punëkryesi apo ndonjë subjekt të është dënua për këtë, kurse projektet duhet filluar sa më herët-në Pranverë e jo të zhagiten problemet, kurse kemi rastet se, shumica e fshtrave, nuk janë të përfshira në menaxhimin e mbeturinave. Sa u përket raporteve, e kuptoj se shumçka nga ato kanë konceptet e viteve të mëhershme, por të kihet parasysh përdorimi i shkurtesave adekuate që aktualisht janë në përdorim zyrtar, si psh.AKM-AKP ose SHPK – PK, që kanë ngel në përdorim që nga koha e administratës së UNMIK-ut. Për DEkonomisë vlen të merret se çka do të bëhet me objektet e karakterit të përkohshëm nëpër fshatra dhe ekspozimin e mallërave-sidomos gjatë sezonit veror e ne, në Restelicë, nuk kemi hapësira publike, pos QMF-së dhe shkollës e që uzurpimet nuk po kanë të ndalur e në Raport përmendet vetëm një rast?! Pra, unë do të përkrahi këtë raportim, duke kërkuar sqarime për çështjet e ngritura nga kryetari apo drejtorët kompetent?

z.Zaim Hajredini- Pjesërisht, pajtohem me disa kritika e qëllimi ynë është që Dragashit t'a shofim si komunë më të mirë e që kjo të ndodh duhet të japim kontributin tonë secili. Siç po shifet, shumica e vërejtjeve që po jepen ndaj raporteve janë të karakterit teknikë e që ka mundësi të korigjohen e ne-si AKR, jemi të gatshëm të bashkëpunojmë me të sektorët relevant, që problemet të zgjidhen.. Është normale, se në aspektin e bashkëpunimit, duhet të vijmë tek rezultatet më të mira e me këtë rast psh. do

të përmendi drejtorin e DKulturës që thekohet e që ka dëshirë për dhurata të mira dhe për nevojën e punës edhe më të mirë, apo ne të arsimit që përmes DKarsimit të ofrojmë të ofrohen shpërblime për nxënës, por që mundësit buxhetore reduktojnë shumë gjëra e që ne e kemi miratuar atë e jo drejtorët. Sa u përket aktiviteteve, ku kanë marr pjesë nxënësit, ata nuk kanë qenë të ftuar nga ana e drejtorit të DKulturës, por nga drejtorët e shkollave e që psh. ne në shkollën e Blaçit nuk e kemi pasur problem, nga se vetë shkolla, nga buxherti i vet, ka siguruar transportin dhe ushqimin për nxënës e që nuk ka qenë DKulturës përgjegjës, për këtë. Me këto aktivitete do të vazhdohet, por mos të ketë dilema e mospajtime se kush për çka është kompetent e që, me rastin e miratimit të buxhetit, të merren parasysh edhe këto çështje.

z.Naser Myrtezani- E falënderoj kolegun parafolës, por nuk ka nevojë të dilet në foltore e të mbrohet drejtorit i DKRSportit i cili është vëllau i juaj?! Këtu është vetë drejtori dhe ai mund të jep sqarime. Ne dijme se si funksionojnë gjërat dhe ju kisha lutur që, herëve tjera, të jeni më të kujdesshëm e të paraqitet vetë vëllau i juaj, pasi se nesër, me Ligjin e ri të Pagave do të ketë pagën 1 mijë euro e ai do të ketë përgjegjësi për lëmin që e përfaqëson?!

z.Arjeta Skeraj- Dua të ndërlihem dhe të pyes lidhur me shëndetësinë se çka po ngjanë me sigurimin e gjinekologut te ne? Ne dijme se komuna e jonë është rurale dhe se është larg për të shkuar në Prizren, kur janë në pyetje shërbimet shëndetësore, dhe kjo çështje është brengosëse, pasi se asnjë shërbim gjinekologjik nuk kryhet në Dragash dhe gjatë vitit 2018 nuk janë kryer as 10% të shërbimeve të tilla. Lidhur me këtë, kryetari i komunës duhet të nënshkruan ndonjë memorandum me Spitalin Rajonal në Prizren se, nëse një kirurg vjen nga Mitrovica në Prizren, mund të vjen edhe nga Prizreni në Dragash. Çështja e dytë është se në Dragash kemi objektin e Qerdhes së Fëmijëve, dëshiroj të pyes se deri ku është arritur që ky objekt të vëhet në funksion, pasi se ka ka nevoja të mëdha nga gratë tona e sidomos nga ato që nesër do të konkurojnë për punë e duhet t'i vendosin fëmijët në qerdhe?! Pse pra Komuna nuk po ndërmerr asgjë, që ky objekt i ndërtuar mirë të jetë në funksion?!

z.Hajrudin Hoxha- Ne sot po e diskutojmë Raportin e Punës së kryetarit dhe organeve ekzekutive dhe pajtohemi me konstatimet e sidomos në sektorin e shëndetësisë e obligimi i ynë është që popullata të jetë e shëndosh. Pajtohemi me konstatimin e kolegut Samidin Xh. lidhur me aparatën e laboratorisë në ambulancën e dërguar në Bresanë dhe kërkoj që, menjëherë, të largohet, por kjo s'do të thotë të kritikojmë njëri-tjetrin, si dhe desha të falënderoj QKMF-në që janë anagazhuar për rinovimin e QMF-së në Restelicë përmes KFOR-it Turk dhe me aparaturën e dërguar dhe në Krushevë, që tani pacientët nuk kanë obligim të vijnë në Dragash, për analiza. I propozoj drejtorit të DSH-së që, posaçërisht, të anagazhohet lidhur me sigurimin e gjinekologut dhe një pediatri në QKMF-në e Dragashit, qoft me konkurs apo edhe përmes sigurimit nga Prizreni. Vitin e kaluar, s'bashku me kolegun Artan L. kemi qenë në Mshëndetësinë, për t'u ankuar lidhur me Statutin e QKMF-së te ne, ku përmendet funksionimi i internistit, pediatri etj. e që propozoj që një kërkesë e tillë, sërish, t'i drejtohet MSH-së e ne jemi komunë rurale e që kemi nevojë reale, me 70 km larg nga Prizreni, siç është Restelica, me kushtet e vështira gjatë dimërit. Po ashtu, e falënderoj DUrbanizmit pasi se, për herë të parë, në Restelicë u bë kanalizimi, rezervoari i ujit, kurse në Krushevë ngel ura, si projekt i dështuar?! Sidoqoft, çdo plan ka edhe lëshime, por duhet pasur parasysh se, ai që punon edhe mund të gabon.

z.Shpetim Hajredini- Dëgjova diskutimet paraprake e që me disa pajtohem e me disa jo, por e di se ne duhet të punojmë për të mirën e komunitetit e që problemet i kemi të njohura dhe mund të themi se gjendja nuk është e mirë e që pajtohem shumica nga ne dhe se lëshimet, me vite, nuk mund të përmirësohen brenda një vitit. Unë pajtohem me pjesën më të madhe të raporteve të drejtorateve, që edhe pse ka lëshime, mendoj se ka mundësi të përmirësohen, në të ardhmen, dhe plotësisht besoj në pushtetin ekzekutiv i cili, besoj, se e ka edhe përkrahjen tonë dhe kërkoj nga kolegët, që bashkarisht, të shkohet kah prosperiteti, duke i lënë ndikimet politike në të mirë të qytetarëve dhe të Komunës sonë.

Kryesuesi- Po theksoj se në bashkëpunim me OSCE-në, një njerën nga punëtoritë tona, jemi marr vesh që të kemi edhe Raportin e Planin e ZProkurimit, hartimin e Rregullores për Mbrojtje nga Zjarri, që mendoj se pajtoheni me këtë, që t'a kemi në Planin tonë final të Kuvendit?

Kryetari- Ju falënderoj në kontributin e dhënë me diskutime e sugjerime reth Raportit dhe planeve të punës sonë. Në këtë kontekst, lidhur me ujësjellësin qendror, po theksoj se ai është brengë e pushtetit ekzekutiv të Komunës dhe besoj se nuk ka nevojë të flasim për rëndësin e tij për qytetarët dhe Komunën. Ne, gjithësesi, jemi të angazhuar reth kësaj çështjeje, por ju duhet t'a dini se sa janë mundësitë tona në kuadër të procedurave që janë qendër e ku janë të implikuar edhe faktor tjerë, përfshi edhe ato ligjore të kyçura reth zgjidhjes së kësaj çështjeje. Sa u përket kyerjes së punëve në terren, unë pajtohem plotësisht se Projekti duhet të fillon sa më parë të jetë e mundur, por nevojitetn procedurat lidhur me operatorët e kjo po ndikon në vonesa. Sa i përket themelimit të Komisionit Mbikqyrës të Punimeve, unë jam për një Komision të tillë i cili do t'u kontribuonte punëve në këtë drejtim, sepse, në këtë mënyrë, edhe operatorët, edhe qytetarët do të bindeshin se sa po punohet për të mirën e këtij rasti. Sa u përket subvencioneve, mendoj se nuk ka qenë kurrfar problemi që të ofrohet Lista e përfituesëve, por që ju them se vendimet e kryetarit lidhur me këtë dhe çështjet tjera janë publike në web-faqen e Komunës. Sa u përket mbledhjeve publike nëpër fshatra, kjo ka qenë çështje selektive dhe janë përfshirë disa lokalitete, duke i kushtuar rëndësi asaj që të përfshihen lokalitetet më të mëdha dhe, siç e dini, në ato takime kemi debatuar lidhur me çështjet që i preokupojnë qytetarët e sidomos lidhur me investimet kapitale. Pres që, s'shpejti, do të zgjidhim edhe çështjen e zgjedhjes dhe funksionimit të udhëheqësive të fshatrave e që atëherë, më lehtë, do të kemi edhe prioritetet e fshatrave. Sa i përket tatimit në pronë, nuk është se vitin e mëheshëm janë grumbulluar më shumë mjete, por e kemi pasur fabrikën "Remateks" dhe pagesa ka qenë më e madhe. Ndërkaq, sa i përket testit të maturës, mund të them se rezultatet kanë qenë më të mira, por nuk mund të themi se në cilin nivel është dituria e nxënësëve? Reth aparatit laboratorik në QMF në Bresanë, ndoshta është ashtu, siç u tha, dhe se ai, në afatin sa më të shkurtër, do të largohet dhe jemi në procedurë. Nëse dikush mendon se këtu, vërtetë, ka keqpërdorime, unë jam që të inicohet procedura në organet e drejtësisë dhe, nëse ka lëshime teknike, kërkoj që ai të jetë jasht funksionit dhe të vazhdohet me procedura tjera. Sa i përket vendit të lirës në DUrbanizmit, për gjeodetin e pensionuar, po theksoj se edhe këtu jemi duke punuar sipas procedurave që kërkohen ligjërisht dhe me UA-ve. Për DSHPublike, po theksoj se kemi pasur takime paraprake lidhur me gjendjen e rrugëve gjatë sezonit dimëror, që nuk ka pasur probleme të theksuara, me bllokim të rrugëve, dhe se, në mënyrë gjenerale, gjendja e sigurisë ka qenë stabile. Ndërkaq, lidhur me lejet ndërtimore, ato janë dhënë kur kanë qenë të nevojshme . Reth Raportit të Auditimit, po theksoj se ai ka qenë publik në web-faqe dhe, në bazë të tij, ne kemi marr rekomandimet me plane të veprimit. Vërejtjet e dhëna për lëmin e arsimit, siç e dini e kemi një Plan për

shtimin e nivelit të aktiviteteve e që, si Komunë, duhet t'zbatojmë, kurse gjendja nëpër shkolla, diku është mirë e diku më dobët. Sa i përket ndërtimit të shkollës së Buçes, mendoj se qytetarët e sajë duhet të japin kontributim me zgjidhjen e problemeve pronëso- juridike. Lidhur me stimulimet e nxënësëve, shumë varet nga angazhimi i drejtorive të shkollave të cilat edhe zhvillojnë aktivitetet mësimore e kulturo-sportive, përfshi këtu edhe anagzhimet reth shënimit të datave për manifestime shtetërore e komunale. Te subvenciobnet për fermerë, siç e dini, ato ndahen përmes organeve qendrore e çështja e zonave kadastrale është proces i vështirë të përcaktohet nga ne, pasi se kërkon anagzhim shtesë me ekspert edhe nga faktorët më të lartë. Sa u përket realizimit të projekteve, gjendja nuk është shumë e vështirë, nga se ka rezultate, por ka edhe probleme diku, siç e kemi rastin edhe ne në fshatin tim-Bresanë, ku kemi probleme me projektin e kapacitetit të mëngët ujit të pijes. Nga një numër delegatësh kishte pyetje lidhur me marrjen e tenderëve përmes çmimit më të ulët e kjo, vërtetë, nuk varet nga ne, por nga procedurat, përfshi edhe çmimin më të ulët, që vlen si kusht në nivel Republikan dhe fitues janë ata me çmim më të volitshëm. Këtë vitë, reth projekteve do t'a kemi më lehtë, pasi se do të anagzohet ndërmarrja e cila do të merret me këto çështje. Lidhur me shpronësimin e kërkuar për atë rrugë në pjesën e poshte të Dragashit, kjo është çështje ndieshme, pasi se fjala është për procedura pronëso- juridike ku implikohen persona privat. Ndërkaq, (mos) pjestëmarrja e delegatëve në takimet tona manifestive, kjo varet nga ndërgjegjja e tyre personale. Reth mospërfshirjes së disa zyreve-shërbimeve në Raport, duhet ditur se, disa prej tyre, obligim e kanë të njoftojnë vetëm kryetarit dhe ato kontakte janë normale dhe zyrtare. Lidhur me objektet e karakterit të përkohshëm, duhet një përcjellje e gjendjes dhe, për disa që parashihet nevoja reale, duhet bërë largimine tyre, jo vetëm në ndonjë fshat, por në tërësi dhe paraqitjet e tilla, të arsyeshme, mund të bëhen e zhvillohet procedura përmes DUrbanizmit. Lidhur me mungesën e gjinekologut, unë kam kontaktuar me QSpitalore në Prizren, që mendoj se, s'shpejti, do të kemi ndonjë zgjidhje të pranueshme, përmes nënshkrimit të një Memorandumi të Mirëkuptimit, kurse sa i përket çështjes së Qerdhes së Fëmijëve, nuk ka kurrfar problemi, pos çështjes së punësimit të personave të nevojshëm, sepse ne nuk kemi mundësi të hapjes së vendeve të reja të punës për këtë, e në anën tjetër, ministritë e kanë të drejtën e inicimit të procedurave për këtë, përfshi edhe punësimin e punëtorëve të nevojshëm.

z.Samidin Xheladini- Unë e falënderoj për guximin personal kryesuesin e Kuvendit lidhur me aparatën laboratorik në QMF-në në Bresanë dhe kërkoj që të kyçen edhe kryetari dhe nënkryetari, që problemi të zgjidhet dhe se kjo çështje nuk më përket mua personalisht, por punës së suksesshme në laboratorinë atje. Për këtë, unë nuk dua të jem faktor i cili do të dëmtoj dikend përmes anlizave që bëj ndaj pacientëve dhe për këtë kërkoj të themelohet një Komision me persona kompetent e profesionist, që të konstatohet gjendja faktike e atij aparati, duke u bërë një Raport zyrtar bazuar në dokumentacionin e tij dhe të dihet se nga kush u manipulua me ate?! Po theksoj se, ai aparat është i mirë në aspektin teknikë, por nuk e dijmë anën praktike përderi sa mos të verifikohet se ai ofron analiza të sakta e unë, personalisht, nuk mund të punoj me një aparat të tillë dhe të lëshoj rezultate. Kemi pasur raste konkrete kur shifrat e rezultateve kanë qenë alarmante e që pacinetët kanë shkuar në Prizren e që rezultatet kanë qenë tjerë?! Ju lutem, kjo nuk është lojë dhe kërkoj që kjo gjendje e krijuar të verifikohet, sepse zgjidhje tjetër nuk ka. Për këtë, drejtori i im më është kërcnuar se, nëse nuk e pranoj këtë aparat, mund të shkoj në shtëpi?! Unë e di se këtë mundet t'a bëj, pasi se edhe vëllaun tim, sa e sa vire, e ka dërguar në shtëpi,

me vendim të nënshkruar nga ish-kryetari Salim Jenuzi. Për gjendjen e krijuar tani, vetëm kryesuesi aktual ka dhënë kontribut dhe atë, jo për mua personalisht, por për shkak të qytetarëve dhe profesionit si mjek që është. Unë me këtë problem po ballafaqohem dhe e ndiej atmosferën kur po vij në furnizohem në QKMF-në në Dragash, e kjo po më ngjanë, që disa viteve të fundit. Pra, aparati i tillë nuk mund të vëhet në funksion, përdesi sa nuk bëhet verifikimi i rezultateve në më shumë lokacione dhe aparata. Një aparat e kanë dërguar në Krushevë e që e meriton, por unë punoj që 20 vjet dhe e pres një aparat të tillë dhe, s'është hera e parë, që kështu po veprohet. Zyra Japoneze ka dhënë mjete në vlerë prej 12 mijë euro me të cilat është siguruar aparati i ri i cili po qëndron në depo, që dy vite, e për këtë dëshiroj të ndërmerren masa, kurse unë jam i gatshëm të bashkëpunoj?!

Kryesuesi- Nëse janë paraparë mjetet që, për fshatin Bresanë të blihet aparati i ri, atëherë atje duhet të dërgohet aparati i ri e nuk vjen në shprehje aparat tjetër i cili nuk është i ri?!

Kryetari-Tani e dijmë se si ka ardhur deri te kjo gjendje dhe diskutimet e këtilla dhe nuk guxojmë t'i ven në dilema qytetarët se a punon mirë apo jo aparati. Pra, ai aparatit duhet të largohet nga funksioni dhe të verifikohet validiteti i tij përmes themelimit të një Komisioni. Për cilin do aparat tjetër, mund të them se kemi mjete të mjaftueshme për t'u blerë, nëse tregohet nevoja?!

z.Nexhat Isufi- Po, por problemi këtu qëndron se kush do të merr përgjegjësinë e, siç po duket, në njëfar mënyre këtu po luajmë, "të jepet apo mos të jepet gol"?! Dikush e ka sjell atë aparat për të përfunduar punën e vetë e dikush paska përfituar?! Për këtë, duhet gjetur fajtorin dhe mos të bëhen klasifikime dhe të thuhet se, nëse dikush ka gabuar-ka gabuar. Nëse është thënë se aparati duhet të jetë i ri, përmes përskrimeve adekuate apo shifrave, ai duhet të jetë i ri e jo i përdorur?! Po bëhen gabime kur po tolerohen lëshimet dhe gabimet e këtilla. Edhe problemi me ujë në Bresanë ekziston e këtë më së miri e dijnë ata që janë nga ai fshat. Ju lutem, kolegë të nderuar, ne për atë ujësjellës kemi dhënë 200 mijë euro e ato janë mjetet e qytetarëve tonë e për këtë dikush duhet të jep përgjegjësi, pasi se neve populli na ka dhënë besimin dhe votën e ne nuk guxojmë të luajmë me besimin dhe fatin e tyre?!

Kryesuesi- Të themelohet Komisioni, pasi se drejtori i Shëndetësisë është përgjegjës e ne do të kërkojmë përgjegjësinë e institucioneve të shëndetësisë. Me konstatimin se me këtë çështje të merren DShëndetësisë e MSociale dhe i QKMF-së, e qesim në votim Raportin e Punës, 2018 me planet e punës 2019 dhe kush është "për"-14, 7 "abstenime" dhe 1 votë "kundër", që konstatoj se i miratuar këto dokumente të punës së organeve tona. Në vazhdim, po ju njoftoj me Ftesën e ZBGjinore me rastin e 8-Marsit-Ditës Ndërkombëtare të Grave se, më 8 Mars, do të organizohet një debat lidhur me çështjet e ndryshme reth rolit dhe pozitës së gruas te ne, përfshi këtu edhe funksionalizimin e Qerdhes së Fëmijëve, përmirësimin e pozitës dhe kushteve për gratë dhe të drejtave në vendimarrje. Debat i këtill do të mbahet këtu në sallën e KK-së Dragash e pjesëmarrëse do të janë të gjitha gratë e punësuar në institucione publike në Dragash. Në panel, pos disa disa drejtorive dhe mysafirëve special, do të marrin pjesë edhe kryetari Komunës z.Shaban Shabani, deputetja në Parlamentin e Kosovës z.Duda Balje, mediat lokale , si "Radio Sharri", "TV Opoja", "Gora Press" etj. Për këtë, kontributi i secilit do të jetë në funksion të barazisë gjinore te ne.

z.Laurat Krasniqi- Pos delegatëve, marrin pjesë edhe akterë tjerë dhe Reparti i Gjinekologjisë në Dragash duhet të vehet në funksion. Nuk kemi mjek-e, dhe, nëse nuk ke mjete, si të shkohet në Prizren sepse, kur janë në pyetje çështjet e rolit dhe pozitës së grave, këtu po luhen “dofar lojëra politike”, siç është caktuar te një grua (në rolin e këshilltares) e nuk vejen fare në punë?!

Pika e III-të (trerë) e rendit të ditës

Kryesuesi- Vazhdojmë me punën dhe, në kuadër të kësaj pike të III-të kemi Njoftimin me Raportin e Punës së KKSb-së, për vitin 2018 & Planin e Veprimit, për vitin 2019, që, fillimisht, shkurtimisht, do të na njofton kryetari z.Shaban Shabani- Siç e dini, ky Këshill Komunal për Siguri në Bashkësë është themeluar me Vendimin e Kuvendit tonë Komunal dhe, si i tillë, ka për obligim ligjor të njofton Kuvendin me Raportin e Punës paraprak dhe P/Veprimit, për vitin vijues. Kështu, në material i kemi pasur këto dokumente të KKSb-së sonë e që, paraprakisht, janë miratuar në mbledhjen e mëhershme të KKSb-së, para kësaj seance të Kuvendit e që tani e kemi si pikë të seancës, që kërkoj edhe miratimin nga Kuvendi.

z.Zinaida Elmazi- Ne dje, në mbledhjen e KPFinanca, kemi kërkuar që të kemi edhe një seancë të jashtëzakonëshme lidhur me sigurinë në Komunë, nga arsyeja se ne nuk jemi sa duhet të njoftuar me çështjet e sigurisë, pasi se nuk jemi anëtar të KKSb-së e siguria na takon të gjithëve. Unë, dje, kam dëgjaur se kryesuesi i ynë i Kuvendit qenka sulmuar dhe se qenka rrezikuar siguria e tij dhe, për këtë, kërkoj të informohemi? Po ashtu, këtu po apstrofoj edhe vjedhjet që po ndodhin në trevën e Opojës e sidomos në fshatin Shajne, që do të ishte mirë të kishim një seancë të jashtëzakonëshme të Kuvendit e ku do të janë prezent komandanti i Policisë sonë, për të na dhënë informata më konkrete reth gjendjes aktuale të sigurisë, te ne.

z.Samidin Xheladini- Sipas Raportit të KKSb-së, po del se qytetarët tonë nuk paskan kurrfar probleme me sigursinë te ne, që shpresoj të kemi gjendje të tillë edhe në praktikë, që mendoj se nuk është ashtu dhe befason se, disa nga kolegët tonë nga komuniteti jo shumicë, po marrin informata e ne nuk po i dijmë se sa janë të sakta?! Po na del se, nëse komuniteti jo shumicë nuk ka probleme, se gjendja e sigurisë është e kënaqshme e që gjendja e sigurisë tek shumica nuk po merret parasysh e në Opojë nuk funksionon asnjë Këshill Lokal për Siguri, pos të atij në Krushevë të Gorës? Po ashtu, dua të shprehi kënaqësi se, një fshat i komunitetit jo shumicë, qenka kyçur në sistemin e menaxhimit të mbeturinave-Krusheva. Ne duhet të punojmë që të gjitha fshatrat tona të kyçen në këtë sistem të pastrimit. Ndërkaq, sa i përket kërkesë, për seancë të jashtëzakonëshme, ne jemi të gatshëm që të japim kontributin tonë, që të mbahet një seancë e tillë.

z.Velid Haxhisin- Gjendja e sigurisë,asolutisht, në Komunën tonë nuk mund të jetë pa vepra penale dhe vjedhje apo aksidente trafiku, por qëllimi i KKSb-së, që na e partashtruar Raportin, është zvogëlimi tyre, në minimum. Mua më gëzon fakti i rënies së veprave penale nga 184 në 155 që është inkurajim e po ashtu edhe zvogëlimi i vjedhjeve, vjedhjeve të rënda, aksidenteve në trafik etj. pos dënimeve në trafik të cilat, nga viti në vit, po shënoj rritje. Në këtë kontekst, ky Këshill duhet të inicon fushatë informative, që përmes broshurave, radio-stacioneve etj. t’u tërhiqet vemendja vozitësëve, për të mos paguar shuma të mëdha mjetesh në emër të dënimeve në trafik. Sidoqoft, mendoj se në tërsi, te ne, gjendja është e mirë e që duhet të vazhdohet.

z.Rexhep Kamberi- Të falënderoj dhe theksoj se situata e sigurisë, gjatë vitit të kaluar, ishte më e mirë se më herët dhe më gëzon bashkëpunimi në mes të subjekteve politike si mënyrë për zgjidhjen e problemeve të ne. Sa i përketë trevës së Gorës dhe komunitetit jo shumicë, theksoj se gjendja në terren është mjaft e mirë e madje më e mirë se në pjesën tjetër - të trevës së Opojës, që apeloj në Policinë që gjendja të zgjidhet, Sipas Raportit, gjendja në trafik ka shënuar raste të shtimit të veprave kundërvajtëse, pasi se edhe masat ndëshkuese janë shtuar e që, me gjasë, lejet e vozitjes po i merr gjithkush, rrugët nuk na janë të sigurta. Unë e përkrahi Raportin, si dhe kërkesat për seancë të jashtëzakonëshme për gjendjen e sigurisë?

z.Hajrulla Hoxha- Siç është me rëndësi të jemi të shëndosh, me rëndësi është të jemi edhe të sigurt. Raporti është i mangët nga fakti se, pasi se, çdo ditë, po rrënohet rruga Gllloboçicë-Restelicë e askush s'po ndërmer masa? Kisha kërkuar që, ajo pjesë e rrugë, sidomos nga Gllloboçica-Krushevëa, të sanohet, pasi se i presim njerëzit që do të na arrijnë nga diaspora e nuk ka kurrfar shenje se aty kemi rrëshqitje të gurëve në rrugë?!

z.Zaim Hajredini- Sipas Raportit, po shifet se gjendja e sigurisë, në tërësi, nuk është gjithaq e keqe dhe se, është më e mirë se viteve të mëhershme, dhe pse të mbahet seancë e jashtëzakonëshme lidhur me sigurinë, pos nëse kemi ndonjë rast të posaçëm?!

z.Zinaida Elmazi- Ne dje, në KPFinanca, kemi shqyrtuar materialin e seancës e lidhur me Raportin e sigurisë, por ne nuk kemi informata të mjaftueshme reth sigurisë, pasi se psh. nuk kemi pasur informata reth problemeve të mëdha në Opojë, për dallim nga Gora, ku tani nuk ka probleme dhe, si delegatë të popullit, nuk jemi të informuar sa duhet me sigurinë. Nuk është e thënë që seanca të jetë e jashtëzakonëshme, ne e kërkojmë vetëm pikën e rendit të ditës reth sigurisë, ku do të na referonte, me prezencën e tij, komandanti i Spolicisë, me informata sa më cilësore.

Kryesuesi- Nëse nuk kemi diskutant tjerë, kalojmë në votim dhe kush “për” - të gjithë, që konstatoj se miratuar Raportin & P/Veprimit të KKS-së.

Pika e IV-të (katërtë) e rendit të ditës – “eventuale”...

Vazhdojmë me seancën dhe pikën e zakonëshme -“eventuale”, urdhëroni...?

z.Granit Rifaj – Ne, si GP i PDK-së, përmes këtij Reagimi po e shprehim indinjatën e thellë për incidentin që ndodhi, ditë më parë, ku u sulmua fizikisht kryesuesi i Kuvendit Komunal në Dragash z.Betim Merdiu, nga një qytetarë? GP i PDK-së, ashpër e dënon sulmin fizikë ndaj kryesuesit të Kuvendit Komunal, duke e konsideruar të njejtin si sulm ndaj institucioneve shtetërore. Së pari, ky fakt na shqetëson shumë, pasi që anëtarët e Kuvendit ndejnë pa siguri, për të kryer punët e angazhimet e veta dhe së dyti jemë të detyruar të reagojmë sepse na shqetëson fakti i mos reagimit PDK-së (Dega në Dragash), si dhe institucionet lokale. Rikujtojmë se ky është sulmi i dytë fizikë ndaj përfaqësuesëve të PDK-së në institucione. Lidhur me sulmin e shëmtuar ndaj kryesuesit tonë, kërkojmë nga organet e rendit, që sa më parë, të zbardhin rastin dhe, akterët e këtij akti të shëmtuar, të dalin para drejtësisë, duke marrë dënimin e merituar. Konsiderojmë se ky akt i dhunimit të institucionit tonë, nuk është i drejtuar vetëm kundër kryesuesit të Kuvendit, por kundër të gjithë përfaqësuesëve, stafit administrativ e politikë dhe qytetarëve

të Komunës së Dragashit. Në fund, ia bëjmë me dije opinionit të gjerë se ne, GP i PDK-së në Dragash, i japim mbështetjen dhe përkrahjen tonë të pa rezervë kryesuesit dr. Betim Merdiu për punën dhe përkushtimin e tij në drejtimin e Kuvendit Komunal. Sinqerisht! Grupi Parlamentar i PDK-së-Dragash”.

z.Laurat Krasniqi- Lidhur me rastin jam njoftuar përmes mediave e jo që kam pasur informata detale, pasi se nuk jam polic. Rasti është i keqë dhe nuk është në rregull që, një biznesmen, pavarësisht se kush është dhe çfarë diskutime kanë pasur, të sulmon kryesuesin e Kuvendit i cili përfaqëson institucionin. Unë jam kundër partisë në pushtet, por jam edhe kundër dhunës si mjet për zgjidhjen e problemeve.

z.Zinaida Elmazi - Ne, maksimalisht, e përkrahim këtë reagim dhe atë që u tha lidhur me përkrahjen kryesuesit tonë të Kuvendit. Sot është ai kryesues i Kuvendit e nesër mund të jemi edhe ne dhe, të gjithë, duhet të përkrahim kryesuesin e Kuvendit, në kuptim të këtij Reagimi të PDK-së, që u tha në foltore. Po ashtu, kisha kërkuar, që në emër të delegatëve-femra të na përkrahni, nga se kemi vendosur të kemi një Bord të Grave për të punuar për interesat e grave-nëna, motra dhe nxënësit tonë, Këtu kam një vërejtje të ZBGjinore e, si duket, vetëm unë po i paraqes ato vërejtje lidhur me 8 Marsin-Ditën e Grave. Ajo duhet, këtu me ne delegatet e Kuvendit, të punon më shumë, që pos bashkëpunimit me komunitetin shumicë të fillon bashkëpunimin edhe me komunitetin jo shumicë, pasi se ne dy që jemi nga komuniteti jo shumicë këtu, nuk jemi marrë parasysh dhe as që jemi informuar për diçka?! Përmes e-mailit kemi marrë ftesën për 8 Marsin e, në këtë manifestim, do të janë edhe mediat, si “Radio Sharri” dhe “TV Opoja” e mos harrini se, komunitet jo shumicë, ka edhe “Radio-Bambusi” e kemi pasur edhe “Radio Gorën” e cila u la të digjet nga zjarri dhe, deri tani, ende nuk kemi pasur informata se si erdhi deri te zjarri?! E dyta, pse nuk u ftuar TV stacioni “Svetlost Gore” e ne e dijmë mirë se kemi qenë donator të kamerës me 7 mijë euro për punën e tyre e që duhet të përcillet puna jonë. Edhe diçka z.kryetar e që më brengos personalisht, sepse, çdo ditë, ballafaqohem me mbeturinat, nga vij nga Mliki, ku përgjatë lumit, kemi mbeturinat dhe, më vjen marri, që i përfaqësoj votuesit e fshtait tim e nuk po mund të ndihëmoj. Mjerisht, ky nuk është problem vetëm i Mlikit, sepse nëse shkoni kah destinacioni turistik i Brodit-në dalje të Dragashit do të vëreni deponi të tmerrshme në fshatin Kukajan. Te vendi “Vllashka” afër Vraniçit nuk mund të kalohet rrugës rajonale nga mbeturinat e ngurta. Nëse shkoni deri kah “Tuneli” në Restelicë, prap do të shifni mbeturinat, siç është edhe kah Zlipotoku, me disa deponi, si në qendër po ashtu edhe tek stadiumi. Kjo është sjellje anarkiste e qytetarëve dhe e ndërmarrjeve ndërtimore, që mbeturinat ndërtimore i gjuajnë ku munden. Insistoj tek drejtori Mursel Halili që të përfundohet me caktimin e deponisë për materiale të ngurta. Për këtë, kisha kërkuar seriozitet, sepse gjenratat që po i lëmë pas do të na akuzojnë për mos punë, që të krijohen kushte për zhvillim të turizmit dhe, me buxhet, të ndajmë mjete për pastrimin e deponive të egra, duke vendosur edhe tabelat “ndalohet hudhja e mbeturinave”, që pastaj të dërgohen inspektorët për sanksionimin e kryesëve të ndotjeve në vendet ku ndalohet guajtja e tyre. Në këtë mënyrë, do të forcojmë edhe “Eko Regjionin” i cili është servis i qytetarëve për mirëmbajtjen e higjienës, si parakusht për zhvillimin e turizmit.

z.Laurat Krasniqi- Me sa e di unë, lidhur me mbeturinat ekziston ndërmarrja publike e cila merret me pastrimin e tyre dhe, të tillët, nuk janë të kështu në sistemin e pastrimit. Ne, pjesa Shqiptare i paguajmë shërbimet e kështu ndihemi të diskriminuar e ju, faktikisht, nuk po paguani për këtë e po kërkon shërbime

- pa pagesë e kjo nuk mundet. Ju, si përfaqësues të qytetarëve, duhet të ndërmerrni iniciativa konkrete, që Kompania të bënë pastrimin e tyre në kuadër të kompetencave të sajë. Unë, mendoj se edhe nga komuna e Dragashit kemi përfaqësues në Bordit e kësaj Kompanie e që duhet të informohemi se si funksionon kjo Kompani dhe shërbimet që i ofron dhe secili duhet të merr përgjegjësitë që i takojnë, që gjërat të shkojnë mirë.

z.Zinaida Elmazi- Fshati ynë-Mlik është i kyçur në pastrimine mbeturinave dhe jemi pagues me 100% të këtyre shërbimeve, siç jemi edhe pagues të tatimit dhe, ju kisha lutur, mos reagoni në këtë mënyrë, ndaj meje, nëse nuk keni informata?

z.Rexhep Kamberi- U paraqita për fjalë me qëllimin që të dënoj rastin e sulmit ndaj kryesuesit tonë të Kuvendit, në emër të GIG-ut. Për këtë, kërkoj nga kompetentët, që në afatin sa më të shkurtër, të ndriçohet dhe zgjidhet rasti, që kjo situatë mos të shëndërrohet në praktikë të sulmeve nda institucioneve zyrtare të Komunës së Dragashit.

z.Velid Haxhisin- Unë, edhe pse dje e theksova në KKomunitete, po theksoj edhe këtu se, në mbledhjet e komiteteve, nevojitet të bëhet përkthimi, me paisje përkthimi, për t'u kursyer koha, që mendoj se aparatura e tillë nuk është edhe aq shtrenjët-me disa mikrofonë dhe dëgjuese. Sa u përket mbeturinave, unë do të kisha lutur kryetarin që të urdhëron Inspektionin, që në vende publike, të paraqiten telefonat ku, publikisht, mund të denoncohen gjuajtësit e mbeturinave/ Se a do të janë ata telefona pa pagesë apo jo, kjo është çështje sekondare, por me rëndësi është që ata telefona të ekzistojnë dhe kësaj shtate, njëherë e përgjithmonë, duhet t'i themi "stop", pasi se gjendja është alarmante. Po theksoj edhe këtë se DSHPublike duhet të ketë Plan të përpunuar për kyçjen e fshatrave në sistemin e kyçjes së lokaliteteve tona në menaxhimine mbeturinave. Disa fshatra, edhe më herët, kanë qenë të kyçura në sistem, por për shkak të neglizhencës së Kompanisë pastruese apo mospagesës së faturave, gjendjen e kemi të këfillë dhe kërkoj që gjendja të merret me seriozitet, nga të gjithë?

z.Sevim Avdullahi- Unë po theksoj se, meqenëse delegati i deritashëm z.Vehbi Nazifi ka dhënë dorheqje nga delegati (për arsye personale-kyçjes në Shërbimin Civil të Komunës), kërkoj që , në Komitetin e Komuniteteve, të zgjedhet një anëtar nga PDK-ja dhe atë me z.Granit Rifaj.

Kryesuesi- Ashtu është dhe kush është për këtë propozim, për zëvendësim? Miratohet.

z.Naser Myrtezani- Edhe si parti politike (LDK) e dënojmë sulmin fizikë ndaj kryesuesit të Kuvendit tonë z.Betim Merdiu, duke llogaritur se ky është sulm direkt në institucionet komunale dhe, si akt të këfillë, e trajtom të pa pranueshëm dhe të rrezikshëm.

z.Zinaida Elmazi- Kërkova që në emër të Bordit të Grave, propozimi im të vëhet në votim, që të vazhdohet me punën, që kërkoj nga kolegët të përkrahemi, me votim?

z.Zaim Hajredini- Ajo që ka ngja me kryesuesin, për mua, është shumë shqetësuese dhe e kam pranuar ashtu, jo vetëm si z.Betim, por si kryesues e sidomos që ka ngjarë, si mosmarrveshje, reth organizimit. Për këtë, ndihemi keqë dhe kërkojmë të vazhdojnë hetimet, pasi se ky është rastë tejet i ndieshëm dhe mund të na ngjanë të gjithë neve, që shpresojmë se rastet e tilla mos të ndodhin. Lidhur

me mbeturinat i kemi ato të ngurtat dhe të tjerat të cilat menaxhohen nga Kompania dhe unë ju bashkangjitem kolegëve, që të caktohet vend i posaçëm për mbeturinat e ngurta e të vepron Inspekcioni. Vitine kaluar, me rastin e miratimit të Rregullores, lidhur me këtë, këtë e kemi shqyrtuar e pastaj nuk e kemi përcjellur gjendjen dhe, nëse jemi të gatshëm të caktohet lokacioni, do të jetë më lehtë të sigurohet buxhet apo donator e këtë duhet t'a kuptojmë seriozisht, qoft edhe me një pikë të posaçme të rendit të ditës. Edhe një pyetje, se tani po regjistrohet prona në nivel vendi edhe në mes të bashkëshortëve, si shtëpitë, pronat etj, e problemi qëndron se a do të ketë lirim nga taksa e tatimit në pronë e për këtë duhet të janë gjërate qarta edhe përmes rregulloreve tona.

z.Naser Myrtezani- Ne e përmendëm ftesën e ZÇGjinore e në drejtoratet tona të gjithë janë drejtor-meshkuj, edhe pse dihet se kemi mjaft femëra të shkolluara. Unë sot do të fokusohet më disa çështje që më janë parashtruar nga qytetarët mua, si delegat. E para, që kryetari të më përgjigjet në dy pyetjet e mëhershme, se sa persona janë punësuar nga koha që është kryetar dhe atë për hapjen e rrugës për "Gurin e Zi"-Tetovë, se a ka vu kontakte e që e ka përfshirë gjatë fushatës zgjedhore? Edhe ura në Zaplluxhe është në gjendje të mjerueshme, që mund të bindet çdo kush e qytetarët kërkojnë zgjidhje. Tani fillon sezoni pranveror e rruga Zaplluxhe-Zhur është përplotë gropa e që kërkojmë që ato të sanohen e që kjo vlen edhe për rrugët tjera lokale. Pjesa e dytë e pyetjeve ka të bëjë me investimet, si psh. në Xerrxe janë rregulluar rrugët me kubëza, por nuk kanë përfunduar deri te disa familje, që besojmë mos të jetë në pyetje prapavia politike? Kërkoj që të kubëzohen edhe rrugët e tyre, duke llogaritur në ate, se edhe ato familje atje, kanë dhënë kontributin në vitet e 90-ta për këtë pavarësi që e kemi. Kam kërkesë edhe nga veteranët e UÇK-së të Opojës, që kanë shprehur interesimin e tyre lidhur me shtimin e pagave që janë bërë e që Komuna të ketë një Rregullore për lehtësime ndaj tyre dhe pensionistëve si kategori më e rrezikuar e popullatës, që psh. nëse paguajnë për taksën komunale 40 euro ajo të zvogëlohet në 20 euro, nëse për këtë ka mundësi Komuna?

z.Samidin Xheladini- Kam një propozim për kryetarin, që gjërat të na shkojnë më mirë e ajo ka të bëjë me atë që të inicohet iniciativa se kush e paraqet korrupsionin të shpërblehet me një shumë të caktuar të hollash, e që kjo të përfshihet si kod etikë i zyrtarëve komunal, që do të ishte në të mirë të transparencës në Komunë? Disa komuna, këtë e kanë aplikuar. Edhe me këtë rast, nuk po mundi pa e përmendur çështjen e problemit me ujë të pijes në Bresanë, rrugët për në bjeshkë, edhe spe këtë e kam apstrofuar, disa herë?

z.Sefidin Mejzini- Kam kërkesën që për fëmijët tanë të suigurohet një stadium-terren sportiv e ku epiqendër është "Mejdani i Buzezit" e atje po paguhen nga 50 euro për t'u shfrytëzuar 1 hektarë. Këtë që po e përmendi e kam fjalën për nja 100 të rinjë, pasi se, për këtë, ka gatishmeri të kontribuohet edhe nga ata që jetojnë jasht vendlindjes së tyre, si në Prishtinë etj. e që për këtë të vendosim në seancën tonë, pasi se kjo është për fëmijët dhe futbollin te ne. Lidhur me sulmin ndaj kryesuesit, kërkoj që të kemi një Rezolutë-tekst dhe të votohet, që në këtë mënyrë të mbrojmë institucionet shtetërore?

z.Nexhat Isufi- Pasi se kjo është pika "e ndryshme", po apostrofoj se komunat tjera kanë bërë "bum" lidhur me menaxhimin e mbeturinave e për këtë sivjet është paraparë një shumë buxhetore për eliminimin e deponive ilegale, e te ne, më së shumeti, kemi mbetje të ngurta e dihet se, në shumicën e

fshatrave, nuk kemi këshillat e tyre, për t'u caktur vendet e gjajtjes së tyre? E dyta, sipas ligjeve janë të parapara edhe dënimet mandatore për hudhjen e mbeturinave etj., por kush t'a zbaton, pasi se ne këtu e kemi krijuar atë mendim që mos të bëhen paraqitje të tilla, vetëdija mungon, por, ajo që është e keqe, duhet t'i thuhet e keqe. Drejtori i drejtoratit kompetent po punon me fshatrat, të cilat nuk janë kyçur në menaxhimin e mbeturinave e që kemi arritur t'a kyçim edhe një fshat-Krushevën, por ngelin edhe nja 6-7 fshatra. Kemi qenë në fshatrat Brod e Kukajan e gjendja përgjatë rrugës është vërtetë e e keqe dhe e shëmtuar, edhe përkundër asaj se përgjat një pjese të rrugës është vendosr betoni për mosgjyjtje, gjendja është e keqe e këtu duhet të kyçen inspektorët, duke aplikuar dënime e këto gjërat duhet sqaruar me një mobilizim të të gjithëve, që Dragashi të jetë destinacion turistik e jo i mbeturinave?!

z.Selman Osmani- Kam pyetje për kryetarin? E para-deri ku është arritur me shtëpitë sociale e dyta-Peticioni i banorëve të Krushevës lidhur me ndërrimin e emrit të rrugës "Hasof", si dhe kemi një problem të madh në rrugën Krushevë-Zlipotok ku kemi rrëshqitje të madhe e nën te është një shtëpi e cila është e rrezikuar e që kisha kërkuar nga organi kompetent, të verifikohet gjendja dhe të ndërmerren masa adekuate sanimi?

Kryetari- Fillimisht, po jap përgjigje në pyetjen e fundit reth rrëshqitjeve të gurëve në rrugë e që kanë qëndruar te ne ekspertët e gjeodezisë nga Prishtina e që presim intervenim për këtë, pasi se ka edhe një fond emergjen. Për këtë rast jemi në dijeni, siç jemi në dijeni edhe për në fshatin Rrenc e vende tjera e, pasi se ne nuk kemi ekipe profesiniste për këtë, presim përkrahjen nga Prishtina. Sa u përket mbeturinave, unë plotësisht pajtohem se kemi probleme me mbeturinat e ngurta e fajin për këtë e ka edhe Komuna, nga se nuk është përcaktuar për një vend-deponi të këtillë e që po na krijohen deponi të tilla në afërsi të fshatrave. Një lokacion i tillë shpresojmë se mund të jetë në mes të fshatrave Rrenc e Kapre e që jam bindur edhe vetë se nuk do t'u pengonte këtyre fshatrave. Sa i përket Bordit të Grave, ndoshta, më herë, ka pasur emërime të tilla, por me sa jem në dijeni, tani përzgjedhja e tyre bëhet përmes konkursit e që për këtë duhet të informohemi se cila është procedura. Po ashtu, pajtohem që për takimet e komiteteve të sigurohen paisje përkthimi, por të shofim se çka po bëjm me paisjet e përkthimit në sallë (ku aktualisht po i shfrytëzojmë ato të MAPL-së) e pastaj do të shofim se çka mund të bëjmë për takimet e komiteteve. Lidhur me vendosjen e tabelave sinjalizuese, kjo është obligim konstant i drejtoratit kompetent, siç vlen kjo edhe lidhur me regjistrimin e pronës ndaj bashkëshortëve e që ka qenë një fushatë e tillë, nga a ana e MEF-it. Sa u përket të punësuarëve, gjatë mandatit tim, ende nuk kemi shënime të sakta zyrtare, kurse reth rrugës për në "Guri i Zi", ne sivjet, do të kryejmë obligimet tona deri tek zona jonë kadastrale e që besojmë se, ngjajshëm, do të vepron edhe Prizreni. Sa i përket urës në Zaplluxhe, ndoshta është dëmtuar nga vetë qytetarët dhe do të shifet se si qëndron gjendja me parcelat e pronarëve për reth e që pra ngel çështje për shqyrtim, në të ardhmen. Sa i përket rrugës rajonale Zaplluxhe-Zhur, siç e dini, ky projekt është nën kompetencat e MInfrastrukturës e ne kemi kërkuar interevenime, qofshin ato emergjente, pasi se e dijme se gjendja është e vështirë e gjendjen e krijuar e ka vështirësuar edhe gjuajtja e tepruar e kripës në atë rrugë dhe rrugët tjera te ne. Në tërësi, po them se gjendja nuk është keqë në ekstrem të skajshëm, por jo edhe për lavdata, kurse për përfundimin e investimeve në rrugët e Xerrxes me kubëza, do të kontaktoj me përfaqësuesit e këtij fshati, se cilët janë prioritet e tyre. Lidhur me hartimin e Rregullores së re e cila do të përfshinte lirim nga disa taksa, po theksoj se kjo është e vështirë, nga se shumëçka rregullohet me ligje dhe rekomandimet që vijnë nga niveli qendror. Probleme ka edhe te ura e

Bresanës dhe fakti se në atë fshat është zvogëluar furnizimi me ujë e, ndoshta, ka edhe defekte në rrjet e që mbetet të shifet se çka mundemi, me përmirësimin e motit. Lidhur me paraqitjen e korrupsioneve, mund të them se ideja është e mirë dhe se, komuna të caktuara, kanë filluar me këtë proces, që për paraqitje të rasteve të kompenzohen me të shpërblime, që edhe ne mund të miratojmë një Vendim të tillë, me mjete nga të hyrat vetanake me diku 100 apo 200 euro, varësisht nga rëndësia e paraqitjes së korrupsionit e që mbetet të konsultohemi me financat se nga cilat burime të mjeteve kjo mund të sigurohet. Sa u përket sigurimit të terreneve në lokacionet me të cilat qeverisë AKP-ja e dijmë se kjo nuk varet nga ne dhe, aktualisht, nuk mund të vendosim, por që mund të inicohen biseda reth këtyre nevojave. Sa u përket dënimeve mandatore, mund të them se në këtë drejtim gjendja nuk është gjithaq e mirë e problemi kryesor qëndron në atë se qytetarët nuk po i paraqesin rastet e gjuajtjes së mbeturinave dhe se inspektorët nuk po mund të kujdestarojnë në tërë territorin, për të hasur në raste të tilla. Sa u përket shtëpive sociale, rastet janë në proces si rrjedhojë e iniciativës së delegatëve të “6+” të Kuvendit të Kosovës dhe delegatit Adem Hoxha, që besoj se procedura do të përfundon, siç presim të përfundon verifikimi i rrezikurt në rrugës Krushevë-Zlupotok ku rrezikohet një shtëpi familjare. Në procedurë është edhe Kërkesa e grupit të banorëve të Krushevës për ndërrim të emrit të një rruge e cila pritet të vjen në Kuvend, pas përfundimit të procedurave nga DUrbanizmit.

z.Zinaida Elmazi- Në kuadër të pikës “eventuale” nuk mund të votohet sipas Ligjit e ne këtë e kemi bërë sot, duke e votuar një anëtar të Kkomuniteteve e kjo është dashur të jetë si pikë e posapçme e rendit të ditës.

Kryesuesi- Nëse nuk kemi edhe diçka, me këtë përfundojmë seancën e sotme të Kuvendit tonë.

E përgatiti :

Shërbimi i Kuvendit Komunal

Kryesuesi :

Betim Merdiu

z

